

VENDIM
Nr.122, datë 10.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.110, DATË 16.9.2008 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARQET EOLIKE KARABURUN DHE LLOGARA”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 10.10.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së dhënë nga ERE për ushtrimin e aktivitetit të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike dhe relacionet e përgatitura nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

konstatoi se:

a) ERE, me vendimin nr.110, datë 16.9.2008, ka licencuar shoqërinë “Enpower Albania” sh.p.k. për ushtrimin e aktivitetit të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara.

b) Ky vendim i ERE-s kushtëzohet me realizimin e disa kushteve nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k.

c) Shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. në shkresën drejtuar ERE-s më datë 24.9.2008 ka kërkuar:

1. Ndryshimin e afatit për përfundimin e projektit nga 36 muaj në 75 muaj (pika 1 germa “d” e vendimit) pasi dimensionet e projektit dhe proceset procedurale administrative shqiptare kërkojnë më tepër kohë se periudha 36 muaj duke marrë në konsideratë edhe kohën që nevojitet për nxjerrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

2. Ndryshimin e germës “e” të pikës 1, duke parashikuar pavlefshmërinë e licencës vetëm në rastin e mungesës së raportimit periodik vjetor mbi zhvillimin e aktiviteteve të kantierit, pasi kushtet dhe afatet mund të mos përmbushen si pasojë e forcës madhore dhe se vendosja e një kushti të tillë do të zvogëlonte mundësinë e kreditimit të projektit nga institucionet financiare.

3. Modifikimin e emrit Karaburun dhe Llogara me “Lungare, Karaburun dhe Rrëza e Kanalit”, pasi kjo është zona ku do të lokalizohet projekti.

4. Me shkresën nr.580/2, prot, datë 10.10.2008, shoqëria dërgoi një kronoprogramë të re, si dhe hartat e kërkuara nga ERE, të cilat paraqesin zonën ku do të shtrihet projekti sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008.

d) Kushti i vendosur nga ERE në pikën 1, germa “d” të vendimit nr.11, datë 16.9.2008 merr në konsideratë grafikun e punimeve të paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. në muajin dhjetor 2007. ERE konsideroi se periudha nga dhjetor 2007 në shtator 2008 i kishte shërbyer shoqërisë për përfundimin e procesit të marrjes së autorizimeve dhe duke bërë një diferencë për këtë periudhë konkludoi në afatin prej 36 muajsh.

e) Kronoprograma e re parashikon fillimin e aktivitetit për realizimin e projektit në shtator 2008, përfundimin e studimit të fisibilitetit në qershor 2010, përfundimin e të gjithë projektit dhe vënien në punë të parkut në dhjetor 2014.

f) Kushti i vendosur në pikën 1, germa “e” të vendimit, nuk ka të bëjë me mosrealizimin e projektit për shkak të ngjarjeve që mund të ndodhin si pasojë e forcës madhore pasi në tipin e licencës për aktivitetin përkatës (subjekt i të cilit është shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k.) në pikën 10.2 përcaktohet: Nëse i licencuari përjeton një ngjarje të forcës madhore gjatë afatit të

caktuar për ndërtimin dhe instalimin e centralit elektrik dhe prodhimin e energjisë elektrike do ta njoftojë pa vonesë ERE-n duke kërkuar një zgjatje të këtij afati në përputhje me dispozitat e seksionit 3 të kësaj licence. Kushti i vendosur në vendimin e ERE-s ka për qëllim nxitjen e përgjegjësisë së të licencuarit në respektimin e afateve dhe se ky kusht nuk e pengon shoqërinë të paraqesë kërkesën për shtyrjen e afateve në rastet kur do të jetë e nevojshme duke sjellë argumentet e përshtatshme.

g) Në përcaktimin e vendndodhjes së parqeve Karaburun dhe Llogara, ERE i është referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008 në të cilin në asnjë rast nuk përmendet lokaliteti Rrëza e Kanalit dhe Lungara.

h) Hartat e dërguara nga shoqëria më datë 10.10.2008, në të cilat paraqitet shtrirja e projektit sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008, përputhen me hartat e dërguara më parë në ERE për efekt të aplikimit për licencë në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike,

për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.110, datë 16.9.2009 “Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara” bëhen këto ndryshime:

- Në titullin e vendimit, në fund të fjalisë hiqen fjalët: “...Karaburun dhe Llogara...” dhe shtohen fjalët si më poshtë:

“sipas vendndodhjes së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008 dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria pranë ERE-s për aplikim për licencë.”.

- Në paragrafin e tretë të pikës 1 të vendimit nr.110, datë 16.9.2008 hiqen fjalët “...Karaburun dhe Llogara...” dhe shtohen fjalët si më poshtë:

“sipas vendndodhjes së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008 dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria pranë ERE-s për aplikim për licencë”.

- Pika 1 germa “a”, afati për paraqitjen e studimit të fisibilitetit brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës ndryshon dhe bëhet: - deri më 30 qershor 2010.

- pika 1 germa “d”, afati prej 36 muajsh ndryshon dhe bëhet: - deri më 31 dhjetor 2014.

2. Germa “e” e pikës 1 të vendimit nr.110, datë 16.9.2008, nuk ndryshohet.

3. Plotësimi nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut i të dhënave të kërkuara në aneksin A dhe C të licencës të bëhet sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë “Enpower Albania” sh.p.k. për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta